

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Destinacionet që vlejné", One Albania dhe Business Magazine në mbështetje të agroturizmeve shqiptar e! Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/destinacionet-qe-vlejne-one-albania-dhe-business-magazin-e-ne-mbeshtetje-te-agroturizmeve-shqiptare/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 09:19:17 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 09:04:22 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b661d357195e8fd1130db830ce3b2d9005004aa6189a373ca1032a667508ee98
TEKSTI	a733fbe76fe5f53906f6d09002db665d6b0d7acc71d961a2be44e19de5df1179
PAMJA	afc0de28a00263b24be86c550aaf7f8eb47a898d24158cb706a087dd503d0ccc

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	eb3b0b7e75838165f0f994a7d1edfb34742d086e07ca54771e6a32bfe080931f
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	5542c6f376d7530e05241a95b291e64e02f5f89d799222f37a26423635f8fe31
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/eb3b0b7e75838165f0f994a7d1edfb34742d086e07ca54771e6a32bfe080931f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Lifestyle Travel

“Destinacionet që vlejné”, One Albania dhe Business Magazine në mbështetje të agroturizmeve shqiptare!



Redaksia D

29 Shtator 2026

Destinacionet që vlejné

Shqipëria ka përherë një vend të bukur që pret të zbulohet. Mund të jetë një bujtinë e fshehur mes maleve, një tryezë ku buka piqet ende në saç, një kantinë e vogël mes vreshtave apo një shtëpi e vjetër që ka hapur sërish dyert, këtë herë për udhëtarë nga e gjithë bota. Pas tyre qëndrojnë njerëz që kanë zgjedhur të investojnë aty ku kanë rrënjët. Shumë prej agroturizmeve shqiptare kanë histori frymëzuese, produkte cilësore dhe mikpritje autentike, por ende nuk kanë mjetet për të promovuar si duhet sipërmarrjen e tyre.



Destinacioni i parë
që vlen është zbuluar

POGRADE 11°C



T O P R A D I O

pikërisht për këtë arsye, në korrnik të këtij viti, One Albania dhe business magazine Albania prezantuan “Destinacionet që vlejnë”, një nismë që synon të mbështesë dhe promovojë bizneset e agroturizmit që po krijojnë vlerë për Shqipërinë. Të ftuar në “Wake Up”, Jonilda Filipi, Drejtoreshë e Çështjeve të Korporatës në One Albania, dhe Gert Boshnjaku, themelues dhe drejtues ekzekutiv i New Media Digital, folën për ecurinë e nismës që ka si synim të gjejë agroturizmet që po krijojnë vlerë në zonat ku operojnë dhe t’u japë më shumë mundësi për t’u parë, për t’u lidhur dhe për t’u rritur.



“Në One Albania besojmë se teknologjia dhe promovimi cilësor mund t’i ndihmojnë agroturizmet jo vetëm të bëhen më të dukshme, por edhe të zhvillohen më tej. Mbështetja jonë do të përshtatet me nevojat konkrete të çdo biznesi, duke shkuar përtej lidhjes bazë me internet. Mund të jetë internet i dedikuar, Wi-Fi 7, hostim website-i apo zgjidhje smart që lidhen me mënyrën se si biznesi operon, menaxhon rezervimet apo sistemet e ndryshme. Synimi është të kuptojmë çfarë i nevojitet secilit destinacion dhe të ofrojmë një zgjidhje që i sjell vlerë reale”, tha Jonilda Filipi.



Nisma u drejtohet pikërisht bizneseve që kanë zgjedhur të ndërtojnë diçka aty ku kanë rrënjët. Sipërmarrjeve që kanë rikthyer në jetë shtëpi të vjetra, tradita, receta dhe produkte vendase, por edhe atyre që po sjellin mënyra të reja për të zhvilluar turizmin rural.






“Çdo agroturizëm krijon një zinxhir vlere përtej vetë biznesit: sjell punësim, rikthen traditat dhe i jep zhvillim zonës përreth. Pas shumë prej tyre ka histori që kanë nisur në mënyrë modeste, me dy apo tre njerëz, dhe sot janë kthyer në pika referimi për të gjithë zonën. Pikërisht këto histori duam të zbulojmë dhe promovojmë. Mbështetja mediatike dhe teknologjike u jep atyre një mundësi më shumë për t’u njohur dhe, njëkohësisht, për t’u kthyer në shembuj frymëzues për sipërmarrës të tjerë”, u shpreh Gert Boshnjaku.



Përmes **“Destinacionet që vlejnë”**, secili mund të nominojë një agroturizëm që mendon se meriton më shumë vëmendje. Nominimet do të vlerësohen duke parë jo vetëm eksperiencën që biznesi u ofron vizitorëve, por edhe ndikimin në komunitet, ruajtjen e traditës, kujdesin ndaj mjedisit dhe potencialin për zhvillim. Nisma do të vijojë deri në dhjetor 2026 dhe nominimet mbeten të hapura. Një bujtinë e vogël në mal, një fermë familjare, një kantinë apo një agroturizëm që ka ndryshuar jetën e një komuniteti mund të jetë historia e radhës.



LAJME TË NGJASHME



“Villa Sol Lumière”, një oaz paqeje larg kaosit të qytetit!

1.5 MIN



Një natë, shumë ritme dhe një ndalesë që nuk e kishim planifikuar!

1 MIN





Sezoni sportiv ka nisur dhe të gjitha kampionatet janë në DigitAlb!

1 MIN



Nga 21-23 gusht, zemra e Alpeve Shqiptare do të ketë një tjetër ritëm: "Ah Theth!"

1 MIN



Tifozët kanë një arsye më shumë këtë sezon: Të gjitha kampionatet janë në DigitAlb!

4.5 MIN

MË TË LEXUARAT



"Destinacionet që vlejnë", One Albania dhe Business Magazine në mbështetje të agroturizmeve shqiptare!



Pranoi se është homoseksual, habit me deklaratën aktori i njohur: "E kishin më të lehtë të më shihnin si një..."



"Villa Sol Lumière", një oaz paqeje larg kaosit të qytetit!



Vjeshta kalohet më bukur me muzikën e përzgjedhur nga DeeJay-t e TAR!



Nga dhoma e hotelit me Guardiolen të 15 vite si drejtor i Lazios dhe aventura të Milani, Igli Tare në një rrëfim ndryshe!



Ben Affleck pranon se fëmijët qeshin me të kur përpiqet t'u japë këshilla për dashurinë?



Rita Ora tërheq vëmendjen me paraqitjen e fundit, vë në pah linjat trupore!



Vdekja e Giorgos Mazonakis, zbulohet mesazhi i fundit për trajtimin dhe pagesën...



"Para nga qielli"/Parashikimi i Baba Vanga-s për dy shenjat e zodiakut!



Andy Carroll rikthehet në fushën e futbollit pas rrëfimit për sulmin seksual!

EDITORI SUGJERON



"Destinacionet që vlejnë", One Albania dhe Business Magazine në mbështetje të agroturizmeve shqiptare!



"Dashuria ma ngroh zemrën, shumica e vajzave janë të padashurara"/Amber Candy: Kur shoh krevatin bosh në mëngjes...



Televizioni hapi i radhës? Amber zbulon ekskluzivisht projektin e ri: Njerëzit duan lumturi, një show që...



"Ku ka më mirë se të kesh një jetë të lirë?"/Amber: Djemtë shqiptarë kanë kompleks...




"Një njeri që ka ndryshuar identitetin..."/Amber Candy: Jam shumë e fortë për t'ia dalë në Shqipëri!



Flirt me ndonjë nga banorët? Amber: Më mirë t'i nxjerr vetë të palarat, se sa të m'i nxjerrin të tjerët...




"Në BBV kupton veten..."/Do të lidhej me një banor brenda shtëpisë? Amber: Unë godas që në fillim!



"Nuk duhet të rihija, u stepa sepse..."/Amber Candy: Nuk mund të godasësh një banor që është i lodhur...



7 shenja që mund të tregojnë
rezistencë ndaj insulinës!



Bëni kujdes! 10 zakone të
përditshme që mund të
shkaktojnë rritje të sheqerit në
gjak...



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.